

**SKK 5 “AKTIVET AFATGJATA MATERIALE DHE AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE”
- I PËRMIRËSUAR**

	<i>Paragrafët</i>
PËRMBAJTJA	
OBJEKTIVI DHE BAZA E PËRGATITJES	1 - 3
FUSHA E ZBATIMIT	4 - 6
PËRKUFIZIMET KRYESORE	7
TRAJTIMI KONTABËL PËR AKTIVET AFATGJATA MATERIALE	8 - 46
Njohja	8 - 10
Matja fillestare	11 - 17
Vlerësimi i mëpasshëm	18
Modeli i kostos	19
Modeli i rivlerësimit	20 - 28
Vlera e amortizueshme dhe amortizimi	29 - 42
Përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtja	43 - 46
TRAJTIMI KONTABËL PËR AKTIVET AFATGJATA TË INVESTUARA	47 - 54
Përkufizimi dhe njohja e aktiveve afatgjata materiale të investuara	47 - 49
Matja fillestare	50 - 51
Vlerësimi i mëpasshëm	52
Transferimet	53 - 54
TRAJTIMI KONTABËL PËR AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE	55 - 72
Njohja	55 - 56
Matja fillestare	57 - 65
Vlerësimi i mëpasshëm	66 - 72
ÇREGJISTRIMI I AKTIVEVE AFATGJATA MATERIALE DHE JOMATERIALE	73 - 76
AAM DHE AAJM TË MBAJTURA PËR SHITJE	77 - 81
ZHVLERËSIMI I AKTIVEVE AFATGJATA MATERIALE DHE JOMATERIALE	82 - 105
Parimet e përgjithshme	82 - 84
Treguesit e zhvlerësimit	85 - 88
Matja e shumës së rikuperueshme	89 - 91
Vlera e drejtë pakësuar me kostot për shitje	92
Vlera në përdorim	93 - 98
Njohja dhe matja e humbjes nga zhvlerësimi për një njësi gjeneruese të parasë	99 - 101
Kërkesa shtesë për zhvlerësimin e emrit të mirë	102
Rimarrja e humbjes nga zhvlerësimi	103
Rimarrja për një njësi gjeneruese të parasë	104
Rimarrja për një aktiv të veçantë të zhvlerësuar	105

	PARAQITJA NË PASQYRAT FINANCIARE	106 - 107
	SHËNIMET SHPJEGUESE	108 – 114
	DISPOZITA KALIMTARE	115
	DATA E HYRJES NË ZBATIM	116
	KRAHASIMI ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR PËR NVM-të (2009)	117
	BAZA E KONKLUZIONEVE	
	UDHËZUES PËR ZBATIM	
	OBJEKTIVI DHE BAZA E PËRGATITJES	
1	Objekti i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 5 <i>Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale</i> (SKK 5 i përmirësuar), miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga Ministri i Financave, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëpasshëm të aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale si dhe të shpjegimeve të nevojshme në pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe të raportimeve financiare të pranuar në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të cilave përshkruhen në Ligjin nr. 9 228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” publikuar në prill 2004, i ndryshuar.	
2	SKK 5 mbështetet në një numër standardesh ndërkombëtare të kontabilitetit, përfshirë SNK 16 <i>Aktivet afatgjata materiale</i> , SNK 38 <i>Aktive jomateriale</i> , SNK 36 <i>Zhvlërësimi i aktiveve</i> , SNK 23 <i>Kostot e huamarrjes</i> dhe SNRF 5 <i>Aktivet afatgjata të mbajtura për shitje dhe operacionet e vijueshme</i> . SKK 5 i përmirësuar është ndryshuar për t’u bërë i krahasueshëm me Seksionin 16 <i>Aktivet afatgjata materiale të investuara</i> , Seksionin 17 <i>Toka, Ndërtesa, Makineri dhe Pajisje</i> , Seksionin 18 <i>Aktivet afatgjata jomateriale përveç emrit të mirë</i> , Seksionin 25 <i>Kostot e huamarrjes</i> , Seksionin 27 <i>Zhvlërësimi i aktiveve</i> , të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për NVM- të (2009). Një tabelë korresponduese e paragrafëve të Standardit me paragrafë të SNRF për NVM (2009), është dhënë në paragrafin 117. Për rastet, të cilat nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 5 e përmirësuar ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike duhet që, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare dhe të ndryshimeve të fluksit të mjeteve monetare dhe të kapitalit të njësisë ekonomike, siç kërkohet në nenin 9 të Ligjit nr. 9228, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, publikuar në prill 2004, i ndryshuar.	
3	Pasqyrat financiare do të përgatiten mbi bazën e konceptit të materialitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nuk do të zbatohen për zërat jomaterialë. Parimi i materialitetit përkufizohet dhe sqarohet në paragrafët 40 deri 90 të SKK 1 i përmirësuar.	
	FUSHA E ZBATIMIT	
4	Ky Standard do të përdoret për trajtimin kontabël të: (a) aktiveve afatgjata materiale (b) aktiveve afatgjata materiale të investuara (c) aktiveve afatgjata jomateriale, përveç emrit të mirë (d) aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale të mbajtura për shitje.	
5	Ky standard nuk zbatohet për: (a) aktivet biologjike (shih SKK 13 <i>Aktivet biologjike dhe marrëveshjet konçesionare</i>); (b) aktivet financiare (shih SKK 3 <i>Instrumentet financiare</i>); (c) emrin e mirë (shih SKK 9 <i>Kombinimet e bizneseve dhe konsolidimi</i>); (d) të drejtat minerare dhe rezervat minerale, të tilla si nafta, gaz natyror dhe burime jorigjeneruese të ngjashme.	
6	Ky standard përfshin edhe trajtimin kontabël të zhvlërësimit të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale përveç emrit të mirë.	
	PËRKUFIZIMET KRYESORE	
7	Më poshtë jepen përkufizimet e disa termave kryesorë të përdorura në këtë standard: <u>Aktivet afatgjata materiale (AAM)</u> janë aktive materiale që:	

	<p>(a) përdoren nga njësia ekonomike për prodhimin e mallrave, kryerjen e shërbimeve apo për t'ua dhënë me qira palëve të treta, ose përdoren për qëllime administrative, dhe</p> <p>(b) priten të përdoren në më shumë se një periudhë kontabël.</p> <p><u>Aktive afatgjata jomateriale (AAJM)</u> janë aktive të identifikueshme jomonetare pa përmbajtje fizike, të mbajtuara për qëllim prodhimin e produkteve ose furnizimin e mallrave ose shërbimeve, për t'ua dhënë me qira të tretëve ose për qëllime administrative. Një aktiv i tillë është i identifikueshëm kur:</p> <p>(a) është i ndashëm, d.m. th i aftë për të qenë i ndarë nga njësia ekonomike dhe shitet, transferohet, liçensohet, jepet me qira ose shkëmbehet, ose individualisht ose së bashku me një kontratë të lidhur, aktiv ose detyrim, ose</p> <p>(b) lind nga të drejtat kontraktuale ose të tjera ligjore, pavarësisht nëse këto të drejta janë të transferueshme ose të ndara nga njësia ekonomike ose nga të drejtat dhe detyrimet e tjera.</p> <p><u>Aktivitet afatgjata të mbajtura për shitje</u>, janë elemente të AAM-së ose AAJM-së, që ka shumë mundësi të shiten brenda 12 muajve të ardhshëm pas datës së raportimit.</p> <p><u>Amortizimi</u> është shpërndarja sistematike e vlerës së amortizueshme të një AAM-je ose një AAJM-je përgjatë jetës së tij të dobishme.</p> <p><u>Vlera e amortizueshme</u> është kostoja e një aktivi ose një vlerë tjetër që zëvendëson koston, minus vlerën e rikuperueshme të aktivit.</p> <p><u>Jeta e dobishme</u> është:</p> <p>(a) periudha gjatë të cilës një aktiv pritet të përdoret nga njësia;</p> <p>(b) numri i produkteve (ose njësi të tjera të ngjashme) që njësia pret të përftojë nga përdorimi i aktivit.</p> <p><u>Kostoja</u> është shuma e parave (ose ekuivalenteve të parave) e paguar, ose vlera e drejtë e aktiveve të tjera të dhëna për të blerë ose prodhuar një aktiv.</p> <p><u>Vlera e rikuperueshme</u> është shuma e vlerësuar që njësia pret të përftojë nga një aktiv në fund të jetës së tij të dobishme, pas zbritjes së koston së nxjerrjes nga përdorimi.</p> <p><u>Amortizimi i akumuluar</u> është pjesa e amortizueshme e një aktivi, tashmë e amortizuar dhe e njohur si shpenzim.</p> <p><u>Kostot e huamarrjeve</u> janë kostot e interesit dhe kosto të tjera të njesisë, të tilla si tarifatat e shërbimeve, komisionet bankare, diferencat e këmbimit, që rrjedhin nga huamarrjet në monedhë të huaj në atë masë që ato konsiderohen si një rregullim i kostove të interesit në lidhje me marrëveshjet e huave dhe kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me huamarrjet.</p> <p><u>Humbja nga zhvlerësimi</u> është shuma me të cilën vlera kontabël e një aktivi ose një njësie gjeneruese parash e tejkalon shumën e tij të rikuperueshme</p> <p><u>Vlera e drejtë</u> është çmimi që do të pranohej për të shitur një aktiv ose që do paguhej për të transferuar një detyrim, në një transaksion të zakonshëm midis pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes.</p> <p><u>Vlera kontabël neto</u> është shuma me të cilën një aktiv njihet në pasqyrën e pozicionit financiar (pasi zbritet amortizimi i akumuluar dhe humbjet e mundshme nga zhvlerësimi).</p> <p><u>Shuma e rikuperueshme</u> është vlera më e lartë midis vlerës së drejtë të një aktivi (pakësuar me koston e shitjes) dhe vlerës së tij në përdorim.</p> <p><u>Kostot e shitjes</u> janë koston-shtesë që lidhen drejtpërdrejt me shitjen e një aktivi ose të njesisë gjeneruese të parasë, duke përjashtuar koston financiare dhe tatim fitimit.</p> <p><u>Vlera në përdorim</u> është vlera aktuale e flukseve të ardhshme të vlerësuar të parasë, që pritet të vijnë nga përdorimi i një aktivi ose nga dalja e tij jashtë përdorimit në fund të jetës së tij të dobishme.</p> <p><u>Njësia gjeneruese e parasë</u> është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjenerojnë parà, të cilat janë kryesisht të pavarura nga hyrjet e parave nga aktive të tjera.</p>
	TRAJTIMI KONTABËL PËR AKTIVET AFATGJATA MATERIALE (AAM)
	Njohja
8	<p>Njësia ekonomike njeh koston e një zëri të AAM-ve si një aktiv nëse dhe vetëm nëse:</p> <p>(a) aktivi kontrollohet nga njësia ekonomike;</p> <p>(b) është e mundur që nga përdorimi i aktivitet do të hyjnë në njësinë ekonomike përfitime të ardhshme ekonomike;</p> <p>(c) kostoja e aktivitet mund të matet me besueshmëri.</p> <p>Regjistrimi fillestar i AAM-së bëhet zakonisht në momentin e përfutimit të tij nga blerja apo prodhimi.</p>
9	<p>Pjesët e këmbimit, instrumentet dhe veglat e punës mbahen zakonisht si inventar dhe ngarkohen në shpenzime kur ato konsumohen. Megjithatë, pjesët kryesore të këmbimit dhe pajisjet rezervë janë aktive afatgjata materiale kur një njësi ekonomike pret për t'i përdorur ato gjatë më shumë se një periudhe. Në mënyrë të ngjashme, në qoftë se pjesët e këmbimit, instrumentet dhe veglat e punës mund të përdoren vetëm në lidhje me një zë të aktiveve afatgjata materiale, ato konsiderohen si aktive afatgjata materiale.</p>
10	<p>Toka dhe ndërtesat janë aktive të ndara dhe një njësi ekonomike do t'i trajtojë ato veç e veç edhe kur ato blihen së</p>

	bashku.
	Matja fillestare
11	Një element i AAM-së, që plotëson kriteret për njohje si aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar (shih paragrafin 20 të SKK 1 të përmirësuar), matet me kosto. Në kosto përfshihet: (a) kosto e blerjes (përfshirë taksat e importit dhe taksa të tjera të parimbursueshme, zbritur skontot tregtare dhe rabatet) (b) kosto të tjera të drejtpërdrejta që lidhen me sjelljen e aktivitetit në vendndodhjen dhe kushtet e nevojshme për funksionimin e tij, sipas qëllimeve të njësisë (përfshirë koston e prodhimit të aktivitetit, nëse ka të tilla kosto, kostot e përgatitjes së terrenit, lëvrimin fillestar dhe trajtimin, instalimin dhe montimin, si dhe testimin e tij). (c) kostoja fillestare e vlerësuar e çmontimeve të ardhshme të një aktivi dhe të kthimit të terrenit, në të cilin ai ndodhet, në gjendjen fillestare (nëse vlerësimi i tyre përputhet me politikat për krijimin e një provizioni, siç përshkruhet në SKK 6).
12	Të ardhurat dhe shpenzimet që krijohen si rezultat i aktiviteteve të rastësishme gjatë ndërtimit apo zhvillimit të një aktivi afatgjatë material njihen në pasqyrën e të ardhurave në qoftë se këto aktivitete nuk janë të nevojshme për ta sjellë aktivin në vendndodhjen dhe kushtet e shfrytëzimit të paramenduara.
13	Nëse pagesa për AAM shtyhet përtej afateve normale të kredive për pagesë, në përcaktimin e koston të aktivitetit merret në konsideratë vlera aktuale e pagesës. Diferenca mes vlerës nominale dhe vlerës aktuale njihet si një shpenzim i interesit për gjatë afatit të pagesës.
14	Një njësi ekonomike njihet të gjitha kostot e huamarrjes si shpenzim në periudhën në të cilën ato janë kryer.
15	Nëse aktivi përfitohet në këmbim të një aktivi tjetër jomonetar, ose grup aktivesh, ose të një kombinimi aktivesh monetare me aktive jomonetare, kostoja e aktivitetit të marrë matet me vlerën e drejtë, përveç rasteve kur: (a) vlera e drejtë e aktiveve të marra dhe atyre të dhëna nuk mund të përcaktohet në mënyrë të besueshme; (b) veprimi i këmbimit nuk ka përmbajtje tregtare (për shembull, kur aktivet e shkëmbyer janë të ngjashëm). Në të dyja rastet e lartpërmendura, (a) dhe (b), kostoja e aktivitetit të marrë është vlera kontabël e aktivitetit të dhënë.
16	Nëse përbërësit kryesorë të një AAM-je kanë, në mënyrë të konsiderueshme, jetë të dobishme të ndryshme, këto pjesë duhet të njihen fillimisht si elementë të veçantë të AAM-së, duke caktuar norma amortizimi të veçanta për secilin prej tyre, në varësi të jetës së tyre të dobishme.
17	Përcaktimi i koston të AAM-ve, të marra nga grantet qeveritare, do të bëhet në përputhje me SKK 10 <i>Grantet dhe forma të tjera të ndihmës</i> . Përcaktimi i koston të AAM-ve, të marra me qira financiare, do të bëhet në përputhje me SKK 7 <i>Kontabilizimi i qirave</i> . Përcaktimi i koston të AAM-ve, të përfuara nga kombinimet e bizneseve, do të bëhet në përputhje me SKK 9 <i>Kombinimet e bizneseve dhe konsolidimi</i> .
	Vlerësimi i mëpasshëm
18	Njësia ekonomike do të zgjedhë si politikë të saj kontabël modelin e koston (i cili shpjegohet në paragrafin 19), ose modelin e rivlerësimit (i cili shpjegohet në paragrafët 20-28) dhe do të zbatojë atë model për të gjithë klasën e AAM-ve që vlerësohet.
	Modeli i koston
19	Në pasqyrën e pozicionit financiar një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.
	Modeli i rivlerësimit
20	Një klasë AAM, vlera e drejtë e së cilave mund të matet me besueshmëri, paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar me shumën e rivlerësuar, e cila është vlera e drejtë në datën e rivlerësimit, pakësuar në periudhat në vijim me amortizimin e akumuluar të mëpasshëm dhe humbjet e akumuluar të mëpasshme nga zhvlerësimi. Rivlerësimet duhet të kryhen rregullisht, në mënyrë që vlera kontabël të mos ndryshojë materialisht nga vlera që do të rezultonte nëse vlerësimi i AAM-së, në datën e raportimit do të bëhej me vlerën e drejtë.
21	Vlera e drejtë e truallit dhe ndërtesave zakonisht përcaktohet mbi bazën e treguesve të tregut nëpërmjet vlerësimeve të kryera nga vlerësues profesionistë të kualifikuar. Vlera e drejtë e elementeve të AAM-së është zakonisht vlera e tyre e tregut e përcaktuar nga vlerësuesit.
22	Frekuenca e rivlerësimeve varet nga ndryshimet në vlerat e drejta të AAM-së që rivlerësohen. Kur vlera e drejtë e një aktivi të rivlerësuar ndryshon materialisht nga vlera kontabël, atëherë nevojitet të kryhet një rivlerësim tjetër. Disa elemente të AAM-së pësojnë ndryshime të ndjeshme e të paqëndrueshme në vlerat e tyre të drejta, kështu që ata kanë nevojë për rivlerësime vjetore. Rivlerësime të tilla të shpeshta janë të panevojshme për ato elemente të AAM-së, vlera e drejtë e të cilave nuk pëson ndryshime të ndjeshme. Për këtë kategori është i mjaftueshëm një rivlerësim në çdo tre ose pesë vite.
23	Kur rivlerësohet një element i AAM-së, amortizimi i akumuluar në datën e rivlerësimit eliminohet kundrejt vlerës kontabël bruto të aktivitetit dhe vlera neto rideklarohet me shumën e rivlerësuar të aktivitetit, ose rivlerësohet dhe vlera historike dhe amortizimi i akumuluar. Shuma/vlera e rregullimit, që vjen nga rideklarimi ose eliminimi i amortizimit të akumuluar, përfaqëson shtimin ose pakësimin e vlerës kontabël, e cila kontabilizohet në përputhje me paragrafët 26 dhe 27.

24	Nëse rivlerësohet një element i AAM-së, atëherë duhet të rivlerësohet e gjithë klasa e AAM-së ku bën pjesë ky element.
25	Të gjitha elementet e një klase AAM rivlerësohen në të njëjtën kohë për të shmangur rivlerësimet e përzgjedhura të aktiveve, si dhe raportimin në pasqyrat financiare të shumave që janë një përzierje e kostove dhe vlerave të drejta në data të ndryshme.
26	Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta në zërin “Rezerva rivlerësimi”. Por shuma e rivlerësimit njihet si e ardhur në pasqyrën e të ardhurave, për sa kohë dhe në atë masë që ajo anulon humbjen nga rivlerësimi i të njëjtit aktiv në periudhat kontabël paraardhëse.
27	Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave. Por shuma e humbjes nga rivlerësimi debitohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta në zërin “Rezerva rivlerësimi”, për sa kohë dhe në atë masë që ajo kompenson një gjendje kreditore që mund të ekzistojë nga rivlerësimet të mëparshme të këtij aktivi.
28	Teprica nga rivlerësimi, e përfshirë në kapitalet e veta për një element të AAM-së, duhet të kalohet te fitimet e pashpërndara përgjatë jetës së dobishme të aktivit afatgjatë material. Teprica e transferuar çdo vit është diferenca mes amortizimit të llogaritur mbi bazën e vlerës kontabël të rivlerësuar të aktivit dhe amortizimit të llogaritur bazuar mbi koston fillestare të aktivit. Të gjitha tepricat e tjera (nëse ka), të mbetura nga rivlerësimi, duhet të transferohen te fitimet e pashpërndara kur aktivi afatgjatë material çregjistrohet. Transferimet nga tepricat e rivlerësimeve në fitimet e pashpërndara nuk bëhen nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave.
	Vlera e amortizueshme dhe amortizimi
29	Një njësi ekonomike shpërndan vlerën e amortizueshme të një aktivi në bazë sistematike gjatë jetës së tij të dobishme.
30	Vlera e amortizueshme e një elementi të AAM-së njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si shpenzim në mënyrë sistematike përgjatë jetës së dobishme të këtij aktivi. Përjashtime bëjnë aktivet afatgjata materiale me jetë të dobishme pa afat si për shembull, toka (përveç minierave dhe vendeve të përdorura për groposje), punimet e artit me jetë afatgjatë, veprat e muzeve dhe librat të cilat nuk amortizohen. Punimet e artit të marra për qëllime projektimi, si dhe veprat e muzeve dhe librat, që duhet të zëvendësohen pas një periudhe kohe të caktuar, amortizohen gjatë jetës së tyre të dobishme.
31	Një njësi ekonomike duhet të marrë parasysh të gjithë faktorët e mëposhtëm në përcaktimin e jetës së dobishme të një aktivi: (a) përdorimin e pritshëm të aktivit. <i>Përdorimi vlerësohet duke iu referuar kapaciteteve të pritshme të aktivit ose prodhimit të pritshëm.</i> (b) konsumimin fizik të pritshëm, që varet nga faktorë të shfrytëzimit, të tillë si numri i turneve gjatë të cilave aktivi përdoret dhe planet e riparimit dhe të mirëmbajtjes, si dhe kujdesin dhe mirëmbajtjen e aktivit, kur aktivi nuk është në punë. (c) vjetërimin teknik ose tregtar, që rrjedh nga ndryshimet ose përmirësimet në prodhim, ose nga një ndryshim në kërkesat për produktin apo shërbimin e siguruar nga aktivi. (d) kufizimet ligjore apo të ngjashme për përdorimin e aktiveve, siç janë datat e skadimit të kontratave të qirasë.
32	Metoda e zgjedhur e amortizimit duhet të pasqyrojë sistematikisht mënyrën se si do të realizohen nga njësi ekonomike përfitimet ekonomike të ardhshme të aktivit afatgjatë, të përfutuara gjatë jetës së dobishme të tij. Metodat më të zakonshme të amortizimit përfshijnë metodën lineare, metodën mbi vlerën e mbetur dhe metodën e bazuar në përdorim si p.sh metoda e njësisë të prodhuara.
33	Në praktikë shpesh përdoret metoda lineare për amortizimin e AAM-ve. Përdorimi i metodave të tjera merret në konsideratë në rast se ato pasqyrojnë në mënyrë më objektive shpërndarjen e përfitimeve të ardhshme ekonomike gjatë jetës së dobishme të aktivit.
34	Amortizimi duhet të shprehë përdorimin e një aktivi afatgjatë por jo detyrimisht ndryshimin e vlerës së tij. Kështu që objektivi i përzgjedhjes së metodave dhe normave të amortizimit nuk është mbajtja e vlerës kontabël të një aktivi afatgjatë material sa më afër vlerës së tij të tregut, por pasqyrimi sa më me vërtetësi i përdorimit të aktivit.
35	Amortizimi për çdo periudhë do të njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, me përjashtim të rasteve kur një SKK tjetër kërkon që kostoja të njihet si pjesë e kostos së një aktivi. Për shembull, amortizimi i aktiveve afatgjata prodhuese përfshihet në koston e inventarit (shih SKK 4 <i>Inventarët</i>).
36	Nëse ka tregues se ka pasur një ndryshim të rëndësishëm që nga data e fundit e raportimit vjetor në modelin me të cilën një njësi ekonomike pret të konsumojë përfitimet e ardhshme ekonomike të një aktivi, njësi do të shqyrtojë metodën aktuale të amortizimit të tij dhe në qoftë se pritshmëritë ndryshojnë atëherë njësi do të ndryshojë metodën e amortizimit për të pasqyruar modelin e ri. Njësi ekonomike do ta trajtojë ndryshimin si një ndryshim në vlerësimin kontabël në përputhje me SKK 1 <i>Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare</i> .
37	Faktorë të tillë si një ndryshim në mënyrën se si një aktiv është përdorur, konsumimi i parakohshëm, përparimi teknologjik, dhe ndryshimet në çmimet e tregut mund të tregojnë se vlera e mbetur apo jeta e dobishme e një aktivi ka ndryshuar që nga data e fundit e raportimit vjetor. Nëse tregues të tillë janë të pranishëm, një njësi ekonomike do të

	shqyrtojë vlerësimet e saj të mëparshme dhe nëse pritshmëritë ndryshojnë, atëherë njësia do të ndryshojë vlerën e mbetur, metodën e amortizimit ose jetën e dobishme. Njësia ekonomike do ta trajtojë ndryshimin në vlerën e mbetur, metodën e amortizimit ose jetën e dobishme si një ndryshim në një vlerësim kontabël në përputhje me SKK 1 <i>Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare</i> .
38	Nëse vlera e mbetur e një aktivi afatgjatë material është shumë e ulët, atëherë mund të presupozohet që ajo të jetë e barabartë me zero.
39	Çdo njësi ekonomike cakton metodat e amortizimit dhe normat e amortizimit në politikat dhe procedurat e saj kontabël, të cilat duhet të përdoren për amortizimin e aktiveve afatgjata materiale. Për një klasë AAM-je, me elemente individualisht të parëndësishëm mund të zbatohen të njëjtat norma amortizimi për të gjithë klasën. Për elemente individualisht të rëndësishme, siç përcaktohet në paragrafin 16 të këtij Standardi, caktohen norma të veçanta amortizimi për çdo element të AAM-së, në bazë të jetës së dobishme të secilit prej tyre.
40	Amortizimi i një aktivi afatgjatë material fillon kur ai është i gatshëm për përdorim (d.m.th. kur është në kushtet dhe vendin e duhur) dhe vazhdon deri në amortizimin e plotë të vlerës së amortizueshme ose deri sa ai çregjistrohet, del nga përdorimi ose riklasifikohet si i mbajtur për shitje (shih paragrafët 73-81). Amortizimi i një aktivi afatgjatë, që nuk përdoret përkohësisht nuk ndërpritet, me përjashtim kur aktivi është i amortizuar plotësisht. Megjithatë, nëse për llogaritjen e amortizimit përdoret metoda e njësisive të prodhuara, amortizimi llogaritet me vlerë zero, për aq kohë sa nuk ka prodhim.
41	Nëse ka ndonjë tregues që shuma e rikuperueshme e një elementi të caktuar të AAM-së mund të ketë rënë poshtë vlerës së tyre kontabël, atëherë kryhet një test zhvlerësimi në përputhje me procedurat e përshkruara në paragrafët 82-105 dhe, nëse është e nevojshme, vlera e aktivitetit zvogëlohet.
42	Një njësi ekonomike duhet të përfshijë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kompensimin nga palë të treta për zëra të AAM-ve që kanë qenë të zhvlerësuara, të humbura ose të marra me detyrim, vetëm kur kompensimi bëhet i arkëtueshëm.
	Përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtja
43	Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëpasshme i shtohen kostos së AAM-së vetëm nëse ato përmbushin kriteret e përkufizimit të AAM-së dhe kriteret për njohjen e aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar (duke përfshirë këtu aftësinë e tyre për të marrë pjesë në gjenerimin e përfitimeve të ardhshme ekonomike). Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë vitit ushtrimor.
44	Nëse një pjesë e një elementi të AAM-së zëvendësohet, kostoja e pjesës së re i shtohet vlerës kontabël neto të elementit të AAM-së, nëse ajo përmbush kriteret e përkufizimit të AAM-së dhe kriteret e njohjes së aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar. Pjesa e zëvendësuar do të hiqet nga pasqyra e pozicionit financiar, nëse ajo është kontabilizuar si pjesë më vete. Nëse kostoja fillestare (trjedhimisht, edhe vlera kontabël aktuale) e pjesës së zëvendësuar nuk dihet, ajo mund të vlerësohet në bazë të kostos aktuale të kësaj pjese minus amortizimin e vlerësuar.
45	Si kusht për vazhdimësinë e funksionimit të një elementi të AAM-së (për shembull, të një avioni) mund të jetë kryerja e riparimeve të rëndësishme me ose pa zëvendësim të pjesëve të këtij aktivi. Me kryerjen e çdo riparimi kapital, kostoja e riparimit njihet në vlerën kontabël të elementit të AAM-së, nëse plotësohen kriteret për njohje. Vlera e mbetur kontabël e kostos së riparimit të mëparshëm (që është e identifikueshme nga pjesët fizike) çregjistrohet. Kjo ndodh pavarësisht nga fakti nëse kostoja e riparimit të mëparshëm është e përcaktuar në mënyrë të identifikueshme në transaksionin e blerjes apo krijimit të aktivitetit. Nëse është e nevojshme për të përcaktuar se cila ishte kostoja e riparimit të mëparshëm të njohur në vlerën kontabël të aktivitetit të blerë ose krijuar, mund të merret si bazë kostoja e vlerësuar e një riparimi të ardhshëm.
46	Ndryshimet në vlerësimin e një detyrimi të njësisë, në lidhje me: - nxjerrjen nga përdorimi të aktivitetit, - kthimin në gjendjen e mëparshme të aktivitetit si dhe detyrime të tjera të ngjashme që rezultojnë: - si pasojë e ndryshimit në kohën e parashikuar ose shumën e parashikuar të parasë apo mjeteve të tjera, që duhen paguar për shlyerjen e këtyre llojeve të detyrimeve, - ose një ndryshim në normën e skontimit, do t'i shtohen ose pakësohen kostos së aktivitetit afatgjatë material përkatës në periudhën kontabël aktuale. Vlera e re pas këtyre rregullimeve nuk duhet të jetë më e vogël se vlera kontabël. Nëse një zvogëlim i një aktivi afatgjatë material zbret nën vlerën e tij kontabël, teprica njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Nëse rregullimi sjell rritjen e kostos së aktivitetit, njësia ekonomike duhet të shqyrtojë nëse kjo tregon se vlera e re kontabël e aktivitetit mund të mos jetë plotësisht e rikuperueshme. Nëse është kështu, njësia ekonomike bën një test të zhvlerësimit të aktivitetit, duke përllogaritur vlerën e tij të rikuperueshme dhe kontabilizon çdo humbje nga zhvlerësimi, në përputhje me paragrafët 82-105.
	TRAJTIMI KONTABËL PËR AKTIVET AFATGJATA TË INVESTUARA

	Përkufizimi dhe njohja e aktiveve afatgjata materiale të investuara
47	Aktivi afatgjatë material i investuar është pasuria (tokë ose një ndërtesë ose një pjesë e ndërtesës, apo të dyja) e mbajtur nga pronari ose qiramarrësi sipas një kontrate qiraje financiare për të fituar të ardhura nga qiraja ose për vlerësimin e kapitalit ose të dyja, me përjashtim të rasteve kur: (a) përdoret në prodhimin ose furnizimin e mallrave apo shërbimeve ose për qëllime administrative, ose (b) shitet në rrjedhën e zakonshme të biznesit.
48	Interesi mbi një pasuri që mbahet nga qiramarrësi sipas një qiraje të zakonshme mund të klasifikohet dhe trajtohet si aktiv afatgjatë i investuar duke iu referuar këtij standardi nëse, dhe vetëm nëse, pasuria do të plotësonte përkufizimin e një aktivi afatgjatë të investuar dhe qiramarrësi mund ta masë vlerën e drejtë të interesit mbi këtë pasuri pa kosto dhe përpjekje të panevojshme, në baza të vazhdueshme. Ky klasifikim alternativ është i vlefshëm mbi parimin pasuri-për-pasuri (çdo pasuri më vete).
49	Pasuria e përzier do të ndahet duke patur parasysh dy klasifikimet si aktiv afatgjatë i investuar dhe aktiv afatgjatë material. Megjithatë, nëse vlera e drejtë e aktivitetit afatgjatë të investuar nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, pa kosto dhe përpjekje të panevojshme, e gjithë pasuria do të trajtohet si aktiv afatgjatë material.
	Matja fillestare
50	Një njësi ekonomike, në momentin e njohjes mat aktivin afatgjatë të investuar me koston e tij. Kostoja e aktivitetit afatgjatë të blerë për t'u investuar, përfshin çmimin e blerjes dhe të gjitha shpenzimet e ngarkueshme drejtpërdrejt si tarifatat ligjore dhe të ndërmjetësimit, taksat e transferimit të pasurisë dhe kostot e tjera të transaksionit. Në qoftë se pagesa është shtyrë përtej termave të kreditimit normal, kosto është vlera aktuale e të gjitha pagesave të ardhme. Një njësi ekonomike duhet të përcaktojë koston e një aktivi afatgjatë të investuar të ndërtuar nga vetë ajo, në përputhje me paragrafët 11-13 dhe 15.
51	Kosto fillestare e një interesi mbi një pasuri të mbajtur sipas një kontrate qiraje dhe të klasifikuar si një aktiv afatgjatë i investuar do të jetë siç përshkruhet paragrafin 34 të SKK 7 i përmirësuar, edhe në qoftë se qiraja do të klasifikohet si qira e zakonshme por është brenda objektit të të njëjtit standard. Me fjalë të tjera, aktivi njihet me vlerën më të ulët ndërmjet vlerës së drejtë të pasurisë dhe vlerës aktuale të pagesave minimale të qirasë. Një shumë ekuivalente njihet si një detyrim për qiranë financiare.
	Vlerësimi i mëpasshëm
52	Aktivi afatgjatë i investuar, vlera e drejtë e të cilit të mund të matet në mënyrë të besueshme, pa kosto apo përpjekje të panevojshme, do të matet me vlerën e drejtë në çdo datë raportimi dhe ndryshimet në vlerën e drejtë njihen në fitim ose humbje. Nëse një interes mbi një pasuri të mbajtur sipas një kontrate qiraje është klasifikuar si aktiv afatgjatë i investuar, zëri i kontabilizuar me vlerën e drejtë është ky interes dhe jo pasuria bazë. Një njësi ekonomike duhet të trajtojë të gjitha aktivitetet e tjera të investuara si toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje duke përdorur modelin kosto-amortizim-zhvlerësim.
	Transferimet
53	Nëse vlera e drejtë për një zë të aktivitetit afatgjatë të investuar që matet duke përdorur modelin e vlerës së drejtë, nuk është e disponueshme pa kosto ose përpjekje të panevojshme, njësi ekonomike do ta trajtojë këtë zë si <i>toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje</i> deri sa vlera e drejtë të bëhet e disponueshme. Vlera kontabël e aktivitetit afatgjatë të investuar në këtë datë bëhet kosto e tij. Ky është një ndryshim i rrethanave dhe jo një ndryshim në politikën kontabël.
54	Për më tepër, siç kërkohet nga paragrafi 53, një njësi ekonomike do të transferojë një pasuri në, ose nga, aktivitet afatgjatë i investuar vetëm kur, përmbush ose jo më parë përkufizimin e aktivitetit afatgjatë të investuar.
	TRAJTIMI KONTABËL PËR AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE
	Njohja
55	Një aktiv afatgjatë jomaterial (AAJM) njihet vetëm nëse: (a) është e mundur që nga përdorimi i aktivitetit do të hyjnë në njësinë ekonomike përfitime të ardhshme ekonomike; (b) kostoja e aktivitetit mund të matet me besueshmëri (c) aktivi nuk është rezultat i shpenzimeve të bëra brenda njësisë ekonomike për një zë jomaterial.
56	Një aktiv jomaterial i blerë në një kombinim biznesi njihet zakonisht si një aktiv, sepse vlera e drejtë e tij mund të matet me besueshmëri të mjaftueshme. Megjithatë, një aktiv jomaterial i blerë në një kombinim biznesi nuk njihet kur ai rrjedh nga të drejta ligjore ose kontraktuale dhe vlera e drejtë e tij nuk mund të matet në mënyrë të besueshme pasi aktivi ose: (a) nuk është i ndashëm nga emri i mirë, ose (b) është i ndashëm nga emri i mirë, por nuk ekziston ndonjë histori apo evidencë e transaksioneve për aktive të njëjta ose të ngjashme, dhe si rrjedhim vlerësimi i vlerës së drejtë do të ishte i varur nga variabla të pamatshëm.
	Matja fillestare
57	Një njësi ekonomike mat fillimisht një aktiv jomaterial me kosto.
58	Kostoja e një aktivi afatgjatë jomaterial të blerë veçmas përfshin: (a) çmimin e tij të blerjes, duke përfshirë taksat e importit dhe taksat e parimbursueshme të blerjes, duke zbritur

	skontot dhe zbritjet tregtare; dhe (b) çdo kosto që i ngarkohet drejtpërdrejt përgatitjes së aktivit për përdorimin e tij të paramenduar.
59	Një njësi ekonomike njih shpenzimet e kryera brenda saj për krijimin e një aktivi jomaterial, duke përfshirë të gjitha shpenzimet për aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit, si një shpenzim në periudhën kur është kryer, vetëm nëse nuk është pjesë e koston së një aktivi tjetër që i plotëson kriteret e njohjes në këtë standard.
60	Si shembuj të zbatimit të paragrafit të mësipërm, një njësi ekonomike njih si shpenzime në periudhën kur ndodhin dhe jo si AAJM, zërat e mëposhtëm: (a) markat e krijuara brenda njësisë, logot, listat e klientëve dhe zërat e ngjashëm në përmbajtje; (b) aktivitetet e nisjes (d.m.th kostot e nisjes), të cilat përfshijnë kostot e themelimit të tilla si kostot ligjore dhe të sekretarisë të bëra në krijimin e një njësie ekonomike ligjore, shpenzimet për të hapur një strukturë të re apo biznes të ri (p.sh. shpenzimet e para-hapjes) dhe shpenzimet për të filluar aktivitetet e reja ose lançimin e produkteve të reja ose proceseve (d.m.th kostot e parashfrytëzimit); (c) aktivitetet e trajnimit; (d) reklamat dhe aktivitetet promovuese; (e) zhvendosja ose riorganizimi pjesor ose i të gjithë njësisë ekonomike; (f) emri i mirë i krijuar brenda për brenda njësisë ekonomike.
61	Paragrafi 60 nuk përjashton njohjen e një parapagimi si një aktiv kur pagesa për mallra ose shërbime është bërë përpara dorëzimit të mallrave ose kryerjes së shërbimeve.
62	Shpenzimet për një zë jomaterial i cili është njohur fillimisht si një shpenzim, nuk do të njihen në një datë të mëvonshme, si pjesë e koston së ndonjë aktivi.
63	Nëse një aktiv jomaterial është blerë në një kombinim biznesi, kosto e këtij aktivi jomaterial është vlera e tij e drejtë në datën e blerjes.
64	Nëse një aktiv jomaterial është përftuar nëpërmjet një granti qeveritar, kosto e këtij aktivi është vlera e drejtë e tij në datën kur granti është arkëtuar/përftuar, në përputhje me SKK 10 <i>Grante dhe forma të tjera të ndihmës</i> .
65	Një aktiv jomaterial mund të përfitohet në këmbim të një aktivi ose aktiveve jomonetare, ose një kombinimi të aktiveve monetare dhe jomonetare. Një njësi ekonomike mat koston e një aktivi jomaterial të tillë me vlerën e drejtë përveç kur: (a) transaksioni i këmbimit nuk ka përmbajtje tregtare; ose (b) vlera e drejtë si e aktivit të marrë dhe atij të dhënë nuk është e matshme në mënyrë të besueshme. Në këtë rast, kostoja e aktivit matet me vlerën kontabël të aktivit të dhënë.
	Vlerësimi i mëposhtëm
66	Një AAJM do të paraqitet me koston e tij minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.
67	Një njësi ekonomike duhet të shpërndajë shumën e amortizueshme të një aktivi jomaterial në bazë sistematike gjatë jetës së tij të dobishme. Amortizimi për çdo periudhë do të njihet si një shpenzim, përveç nëse një SKK tjetër kërkon që kostoja të njihet si pjesë e koston së një aktivi tjetër.
68	Amortizimi fillon kur aktivi jomaterial është i disponueshëm për përdorim, p.sh. kur ai është në vendin dhe në kushtet e domosdoshme për të qënë i përdorshëm sipas mënyrës së menduar nga drejtuesit. Amortizimi pushon kur aktivi çregjistrohet.
69	Njësia ekonomike do të zgjedhë një metodë amortizimi që pasqyron modelin me të cilin ajo pret të konsumojë përfitimet ekonomike të ardhshme të aktivit. Nëse njësia ekonomike nuk mund ta përcaktojë këtë model të besueshëm, ajo do të përdorë metodën lineare.
70	Të gjitha aktivet jomateriale do të konsiderohen që kanë një jetë të fundme të dobishme. Jeta e dobishme e një aktivi jomaterial që rrjedh nga të drejtat kontraktuale ose të drejta të tjera ligjore nuk duhet të kalojë periudhën e të drejtave kontraktuale ose të drejtave të tjera ligjore, por mund të jetë më e shkurtër në varësi të periudhës gjatë të cilës njësia pret të përdorë aktivin. Nëse të drejtat kontraktuale ose të drejta të tjera ligjore janë mbartur për një afat të kufizuar që mund të rinovohet, jeta e dobishme e aktivit jomaterial do të përfshijë periudhën e rinovimit vetëm në qoftë se ka evidencë për të mbështetur rinovimin nga njësia ekonomike pa kosto të konsiderueshme.
71	Nëse një njësi ekonomike nuk është në gjendje të bëjë një vlerësim të besueshëm të jetës së dobishme të aktivit jomaterial, jeta e dobishme do të supozohet që të jetë dhjetë vite.
72	Një njësi ekonomike duhet të supozojë se vlera e mbetur e një aktivi jomaterial është zero me përjashtim kur: (a) ka një angazhim nga një palë e tretë për ta blerë aktivin në fund të jetës së tij të dobishme; ose (b) ekziston një treg aktiv për aktivin dhe: (i) vlera e mbetur mund të përcaktohet duke iu referuar këtij tregu; dhe (ii) është e mundshme që një treg i tillë do të ekzistojë në fund të jetës së dobishme të aktivit.
	ÇREGJISTRIMI I AKTIVEVE AFATGJATA MATERIALE DHE JOMATERIALE
73	Një njësi ekonomike duhet të çregjistrojë një zë të AAM-ve dhe AAJM-ve kur: (a) e nxjerr atë jashtë përdorimit; ose

	<i>(b) nuk pritet të ketë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i tij ose nga nxjerrja jashtë përdorimit.</i>
74	Një njësi ekonomike duhet të njohë fitim ose humbje nga çregjistrimi i një zëri të AAM-ve kur zëri është çregjistruar (përveç kur SKK 7 <i>Kontabilizimi i qirave</i> kërkon të veprohet ndryshe në transaksionet e shitjes dhe marrjes me qira).
75	Në përcaktimin e datës për nxjerrjen jashtë përdorimit të një zëri, një njësi ekonomike do të zbatojë kriteret në SKK 8 <i>Të ardhurat</i> për njohjen e të ardhurave nga shitja e mallrave. SKK 7 <i>Kontabilizimi i qirave</i> zbatohet në rastet e nxjerrjes jashtë përdorimit nëpërmjet transaksionit të shitjes dhe rimarrjes me qira.
76	Një njësi ekonomike duhet të përcaktojë fitim / humbjet që rrjedhin nga çregjistrimi i një zëri të AAM-ve dhe AAJM-ve, si diferencë në mes të ardhurave neto nga nxjerrja jashtë përdorimit, në qoftë se ka dhe vlerës kontabël të aktivit.
AAM DHE AAJM TË MBAJTURA PËR SHITJE	
77	Elemente të AAM-së dhe AAJM-së, që priten të shiten brenda 12 muajve të ardhshëm pas datës së raportimit, riklasifikohen si aktive afatgjata të mbajtura për shitje dhe paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar si aktive afatshkurtra.
78	Elemente të AAM-së dhe AAJM-së riklasifikohen në pasqyrën e pozicionit financiar si aktive afatgjata të mbajtura për shitje vetëm dhe vetëm nëse ato janë të disponueshme për shitje të menjëhershme dhe shitja e tyre është shumë e mundshme. Për këtë, drejtuesit e njësisë ekonomike duhet të kenë filluar në mënyrë aktive aktivitetet e shitjes dhe t'i kenë nxjerrë këto aktive në treg me një çmim që është i arsyeshëm në krahasim me vlerën e tyre aktuale.
79	Aktivet afatgjata, të klasifikuara si të mbajtura për shitje, vlerësohen me vlerën më të ulët midis vlerës së tyre kontabël dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Ato paraqiten më vete në pasqyrën e pozicionit financiar.
80	Amortizimi i aktiveve afatgjata, të klasifikuara si të mbajtura për shitje, ndërpritet në kohën e riklasifikimit të aktivit. Nëse vlera e drejtë e aktivit (minus koston e përlogaritur të shitjes) është më e ulët se vlera kontabël e tij, aktivi i klasifikuar si i mbajtur për shitje do të zvogëlohet deri në vlerën e drejtë (minus koston e shitjes). Një aktiv afatgjatë i klasifikuar si i mbajtur për shitje, nuk amortizohet edhe pse ai vazhdon të përdoret në prodhim nga njësi ekonomike deri në momentin e nxjerrjes jashtë përdorimit (d.m.th. shitjes).
81	Nëse një njësi ekonomike i ndryshon planet e saj në lidhje me shitjen e aktivit, aktivet riklasifikohen si AAM ose AAJM, duke i vlerësuar me vlerën më të ulët midis vlerës së tyre kontabël të mëparshme (e rregulluar me amortizimin e akumuluar) dhe shumës së rikuperueshme. Rregullimi, në lidhje me riklasifikimin e mundshëm, njihet në pasqyrën e performancës të periudhës kontabël, dhe jo në mënyrë retrospektive.
ZHVLERËSIMI I AKTIVEVE AFATGJATA MATERIALE DHE JOMATERIALE	
Parimet e përgjithshme	
82	Paragrafët 82 deri 105 do të zbatohen në trajtimin kontabël të zhvlerësimit për të gjitha aktivet përveç atyre në vijim, për të cilat SKK-të e tjera përcaktojnë kërkesat e zhvlerësimit: <i>(a) aktivet për tatime të shtyra (shih SKK 11 <i>Tatimi mbi fitimin</i>).</i> <i>(b) aktivet financiare (shih SKK 3 <i>Instrumentet Financiare</i>).</i> <i>(c) aktivet afatgjata materiale të investuara</i> <i>(d) aktivet biologjike në lidhje me aktivitetin bujqësor të matura me vlerën e drejtë pakësuar me kostot e vlerësuara të shitjes (shih SKK 13 <i>Aktivet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare</i>).</i>
83	Një humbje nga zhvlerësimi ndodh kur vlera kontabël neto e një aktivi tejkalon shumën e rikuperueshme.
84	Një njësi ekonomike duhet të njohë një humbje nga zhvlerësimi menjëherë në fitim/ humbjen e vitit.
Treguesit e zhvlerësimit	
85	Një njësi ekonomike duhet të vlerësojë në çdo datë të raportimit nëse ka ndonjë shenjë që një aktiv mund të jetë i zhvlerësuar. Nëse ekziston ndonjë shenjë e tillë, njësi ekonomike do të vlerësojë shumën e rikuperueshme të aktivit. Nëse nuk ka të shenja për zhvlerësim, nuk është e nevojshme të vlerësohet shuma e rikuperueshme.
86	Në vlerësimin që bëhet për të parë nëse ka ndonjë tregues që një aktiv mund të jetë i zhvlerësuar, një njësi ekonomike do të marrë parasysh, minimalisht, arsyet e mëposhtme: Burimet e jashtme të informacionit <i>(a) Gjatë periudhës, vlera e tregut e një aktivi ka rënë në mënyrë të konsiderueshme më tepër se sa pritej si rezultat i kalimit të kohës apo përdorimit normal;</i> <i>(b) Gjatë periudhës kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme me një efekt negativ në njësinë ekonomike, ose do të ndodhin në të ardhmen e afërt, në teknologji, treg, mjedisin ekonomik ose ligjor në të cilin operon njësi ekonomike ose në tregun që një aktiv i përket;</i> <i>(c) Normat e interesit të tregut apo norma të tjera të tregut të kthimit në investime janë rritur gjatë periudhës, dhe rritjet e tyre ka të ngjarë të ndikojnë materialisht në normën e skontimit që përdoret në llogaritjen e vlerës në përdorim të një aktivi dhe të ulët vlera e drejtë (minus kostot e shitjes) e aktivit;</i> <i>(d) Vlera kontabël neto e aktiveve neto të një njësie ekonomike është më e madhe se vlera e drejtë e vlerësuar e njësisë ekonomike në tërësi (një vlerësim i tillë mund të jetë bërë, për shembull, në lidhje me shitjen potenciale të një pjese ose të të gjithë njësisë ekonomike).</i>

	<p>Burimet e brendshme të informacionit</p> <p>(a) Evidenca e disponueshme e përqësimit ose e dëmtimit fizik të një aktivi;</p> <p>(b) Gjatë periudhës kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme me një efekt negativ në njësinë ekonomike, ose pritet të ndodhin në të ardhmen e afërt, në shkallën në të cilën ose mënyra me të cilën, një aktiv është përdorur ose pritet të përdoret. Këto ndryshime bëjnë që aktivi të jetë me kapacitet bosh, të planifikohet ndërprerja ose ristrukturimi i veprimtarisë të cilës i takon një aktiv, të planifikohet nxjerrja jashtë përdorimit e një aktivi para datës së pritshme, dhe të rivlerësohet jeta e përdorimit e një aktivi si jetë e kufizuar në vend që të jetë e pakufizuar;</p> <p>(c) Evidenca e disponueshme nga raportimi i brendshëm që tregon se performanca ekonomike e një aktivi është ose do të jetë, më e keqe se sa pritej; Në këtë kontekst të performancës ekonomike përfshihen rezultatet e shfrytëzimit dhe flukset e mjeteve monetare.</p>
87	Nëse nuk është e mundur të vlerësohet shuma e rikuperueshme e aktivitetit të veçantë, një njësi ekonomike do të vlerësojë shumën e rikuperueshme të njësisë gjeneruese të parasë, të cilës i takon ky aktiv. Do të veprohet kështu meqë matja e shumës së rikuperueshme kërkon të bëhet parashikimi i flukseve të mjeteve monetare dhe ka raste që aktivitetet e veçanta nuk gjenerojnë flukse mjeteve monetare më vite. Një njësi gjeneruese e parasë për aktivin është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që përfshin atë dhe gjeneron mjete monetare të cilat janë kryesisht të pavarura nga hyrjet e mjeteve monetare nga aktive ose grupe aktive të tjera.
88	Nëse ka një tregues që një aktiv mund të jenë i zhvlerësuar, ky tregues mund të bëjë që njësi ekonomike të rishikojë jetën e mbetur të dobishme, metodën e amortizimit ose vlerën e mbetur të aktivitetit dhe ta rregullojë në përputhje me këtë standard edhe nëse nuk është njohur humbje nga zhvlerësimi për aktivin.
	Matja e shumës së rikuperueshme
89	Shuma e rikuperueshme e një aktivi ose e një njësie gjeneruese parash është vlera më e lartë midis vlerës së drejtë pakësuar me kostot për ta shitur dhe vlerës së tij në përdorim. Nëse nuk është e mundur të vlerësohet shuma e rikuperueshme e një aktivi të veçantë, referencat në paragrafet 90-98 për një aktiv duhet të lexohen si referenca edhe për njësinë gjeneruese të parasë.
90	Nuk është gjithmonë e nevojshme të përcaktohet edhe vlera e drejtë e një aktivi pakësuar me kostot për ta shitur, edhe vlera në përdorim e tij. Nëse njëra prej këtyre shumave tejkalon vlerën kontabël neto të aktivitetit, ai nuk është i zhvlerësuar dhe nuk është e nevojshme të vlerësohet shuma tjetër.
91	Nëse nuk ka arsye të besohet që vlera në përdorim e një aktivi tejkalon materialisht vlerën e tij të drejtë pakësuar me kostot për ta shitur, vlera e drejtë e aktivitetit pakësuar me kostot për ta shitur mund të përdoret si shuma e rikuperueshme. Një gjë e tillë ndodh shpesh për një aktiv që është mbajtur për shitje.
	Vlera e drejtë pakësuar me kostot për shitje
92	Vlera e drejtë pakësuar me kostot për shitjen është shuma që përftohet nga shitja e një aktivi në një transaksion të kryer në mënyrë të vullnetshme midis palëve të palidhura me njëra-tjetrën, pakësuar me kostot e shitjes. Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë pakësuar me kostot e shitjes e një aktivi është një çmim në një marrëveshje shitje të detyrueshme në një transaksion midis palëve të palidhura ose një çmim tregu në një treg aktiv. Nëse nuk ka marrëveshje shitjeje detyruese apo treg aktiv për një aktiv, vlera e drejtë pakësuar me kostot e shitjes bazohet në të dhënat më të mira të disponueshme që pasqyrojnë shumën që një njësi ekonomike mund të përftojë në datën e raportimit, nga shitja e aktiveve të saj në një transaksion të kryer në mënyrë të vullnetshme midis palëve të palidhura me njëra-tjetrën, pasi zbriten kostot për shitjen e aktivitetit. Gjatë përcaktimit të kësaj shume, një njësi ekonomike merr parasysh rezultatit e transaksioneve të kohëve të fundit për aktive të ngjashme në të njëjtën industri.
	Vlera në përdorim
93	Vlera në përdorim është vlera aktuale e flukseve të ardhshme të mjeteve monetare që pritet të përftohen nga një aktiv. Llogaritja e kësaj vlerë aktuale përfshin hapat e mëposhtëm: (a) vlerësimin e hyrjeve dhe daljeve të ardhshme të mjeteve monetare që rrjedhin nga përdorimi i vazhdueshëm i aktivitetit dhe nga nxjerrja e tij përfundimtare jashtë përdorimit, dhe (b) zbatimin e normës përkatëse të skontimit në këto flukse të ardhshme të mjeteve monetare.
94	Në llogaritjen e vlerës në përdorim të një aktivi duhet të pasqyrohen elementët e mëposhtëm: (a) një vlerësim i flukseve të ardhshme të mjeteve monetare që njësi ekonomike pret të përftojë nga aktivi; (b) pritjet për ndryshime të mundshme në sasinë apo kohën e këtyre flukseve të ardhshme të parasë; (c) vlerën në kohë të parasë, të përfaqësuar nga norma pa risk e interesit në tregun aktual; (d) çmimin e aktivitetit që mbart pasigurinë e natyrshme; (e) faktorë të tjerë, të tillë si moslikuiditeti, që pjesëmarrësit e tregut do të pasqyrojnë në vlerësimin e flukseve të ardhshme të mjeteve monetare që njësi ekonomike pret të përftojë nga aktivi.
95	Në matjen e vlerës në përdorim, vlerësimet e flukseve të ardhshme të mjeteve monetare do të përfshijnë: (a) hyrjet e mjeteve monetare nga përdorimi i vazhdueshëm i aktivitetit; (b) daljet e mjeteve monetare që janë shkaktuar domosdoshmërisht për të gjeneruar hyrjet e mjeteve monetare nga përdorimi i vazhdueshëm i aktivitetit (duke përfshirë edhe daljet e mjeteve monetare për të përgatitur aktivin për përdorim) dhe mund t'i ngarkohen drejtpërdrejt, ose të shpërndahen në mënyrë të arsyeshme dhe të vazhdueshme, tek

	<p>aktivi;</p> <p>(c) flukset neto të mjeteve monetare, nëse ka, që pritet të marrë (ose të paguajë) për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktivitetit, në fund të jetës së tij të dobishme në një transaksion të kryer në mënyrë të vullnetshme midis palëve të palidhura.</p> <p>Njësia ekonomike mund të dëshirojë të përdorë buxhetet financiare më të fundit apo parashikimet për të bërë vlerësimin e flukseve të mjeteve monetare, nëse është e mundur. Për vlerësimin e flukseve të mjeteve monetare përtej periudhës së mbuluar nga buxhetet më të fundit ose parashikimet, një njësi ekonomike mund të dëshirojë të ekstrapolojë shumat bazuar në buxhetet apo parashikimet duke përdorur një normë të qëndrueshme ose në rënie të normës së rritjes për vitet në vazhdim, me përjashtim të rastit kur mund të justifikohet përdorimi i një normë të rritur.</p>
96	<p>Vlerësimet e flukseve të ardhshme të mjeteve monetare nuk do të përfshijnë:</p> <p>(a) hyrjet ose daljet e mjeteve monetare nga aktivitetet financuese, ose</p> <p>(b) arkëtimet ose pagesat e tatimit mbi të ardhurat.</p>
97	<p>Flukset e ardhshme të mjeteve monetare do të vlerësohen për aktivin në gjendjen e tij aktuale. Vlerësimet e flukseve të ardhshme të mjeteve monetare nuk do të përfshijnë hyrjet ose daljet e vlerësuara të ardhshme të mjeteve monetare që pritet të rrjedhin nga:</p> <p>(a) një ristrukturim në të ardhmen për të cilin një njësi ende nuk është e angazhuar; ose</p> <p>(b) përmirësimi apo rritja e performancës së aktivitetit.</p>
98	<p>Norma (normat) e skontimit e përdorur në llogaritjen e vlerës aktuale do të jetë një normë (normat) para tatimeve e cila pasqyron (pasqyrojnë) vlerësimet aktuale të tregut të:</p> <p>(a) vlerës në kohë të parasë; dhe</p> <p>(b) rreziqet specifike të aktivitetit për të cilat vlerësimet e ardhshme të fluksit të mjeteve monetare nuk janë rregulluar.</p> <p>Norma (normat) e skontimit e përdorur për të matur vlerën në përdorim të një aktiviteti nuk do të pasqyrojë rreziqet për të cilat vlerësimet e fluksit të ardhshëm të mjeteve monetare kanë qenë të rregulluara, për të shmangur në këtë mënyrë llogaritjen e dyfishtë.</p>
<p>Njohja dhe matja e humbjes nga zhvlerësimi për një njësi gjeneruese të parasë</p>	
99	<p>Një humbje nga zhvlerësimi do të njihet për një njësi gjeneruese të parasë nëse, dhe vetëm nëse, shumat e rikuperueshme të njësive është më e vogël se vlera kontabël neto e saj. Humbja nga zhvlerësimi do të shpërndahet për të zvogëluar vlerën kontabël neto të aktiveve të njësive në rendin e mëposhtëm:</p> <p>(a) së pari, për të zvogëluar vlerën kontabël neto të emrit të mirë të caktuar për njësinë gjeneruese të parasë; dhe</p> <p>(b) pastaj, në aktivitetet e tjera të njësive proporcionalisht në bazë të vlerës kontabël neto të çdo aktiviteti në njësinë gjeneruese të parasë.</p>
100	<p>Megjithatë, një njësi ekonomike nuk do të zvogëlojë vlerën kontabël neto të ndonjë aktiviteti në njësinë gjeneruese të parasë më poshtë se vlera më e lartë e:</p> <p>(a) vlerës së tij të drejtë pakësuar me kostot për ta shitur (nëse është e përcaktuar);</p> <p>(b) vlerës në përdorim të tij (nëse është e përcaktuar); dhe</p> <p>(c) zeros.</p>
101	<p>Çdo tejkallim i humbjes nga zhvlerësimi, që nuk mund të shpërndahet në një aktivitet për shkak të kufizimit në paragrafin 100, iu shpërndahet aktiveve të tjera të njësive proporcionalisht në bazë të vlerës kontabël neto të këtyre aktiveve.</p>
<p>Kërkesa shtesë për zhvlerësimin e emrit të mirë</p>	
102	<p>Nëse një njësi ekonomike nuk është në gjendje të bëjë një vlerësim të besueshëm të jetës së dobishme të emrit të mirë, jeta e tij do të supozohet të jetë 10 vjet.</p>
<p>Rimarrja e humbjes nga zhvlerësimi</p>	
103	<p>Për të gjitha aktivitetet e tjera, përveç emrit të mirë, një njësi ekonomike do të vlerësojë në çdo datë të raportimit nëse ka ndonjë shenjë se një humbje nga zhvlerësimi, e njohur në periudhat e mëparshme, nuk ekziston më, ose mund të jetë pakësuar. Shenjat se një humbje nga zhvlerësimi mund të jetë pakësuar ose mund të mos ekzistojë më, në përgjithësi janë e kundërta e atyre të përcaktuara në paragrafin 86. Nëse ekziston ndonjë shenjë e tillë, njësia ekonomike do të përcaktojë nëse e gjitha ose vetëm një pjesë e humbjes së mëparshme nga zhvlerësimi duhet të anulohet. Procedura për të bërë këtë përcaktim do të varet nga fakti nëse humbja e mëparshme nga zhvlerësimi i aktivitetit është bazuar në:</p> <p>(a) shumën e rikuperueshme të këtij aktiviteti të veçantë (shih paragrafin 105); ose</p> <p>(b) shumën e rikuperueshme të njësive gjeneruese të parasë, të cilës i takon aktiviteti (shih paragrafin 104).</p>
<p>Rimarrja për një njësi gjeneruese të parasë</p>	
104	<p>Kur humbja e mëparshme nga zhvlerësimi është bazuar në shumën e rikuperueshme të njësive gjeneruese të parasë të cilës i takon aktiviteti, do të zbatohen kërkesat në vijim:</p> <p>(a) Njësia ekonomike duhet të vlerësojë shumën e rikuperueshme të njësive gjeneruese të parasë në datën e raportimit aktual;</p> <p>(b) Nëse shumata e rikuperueshme e vlerësuar e njësive gjeneruese të parasë e tejkallon vlerën kontabël të saj, atëherë tejkallimi është një anulim i një humbje nga zhvlerësimi. Njësia ekonomike do të shpërndajë shumën e këtij anulimi në aktivitetet e njësive, me përjashtim të emrit të mirë, proporcionalisht me vlerat kontabël të këtyre aktiveve, që i</p>

	<p>nënshtrohen kufizimit të përshkruar në pikën (c) më poshtë. Këto rritje në vlerat kontabël neto do të trajtohen si anulime të humbjeve nga zhvlerësimi për aktivet e veçanta dhe do të njihen menjëherë në fitim/ humbje të vitit;</p> <p>(c) Në shpërndarjen e një anulimi të një humbje nga zhvlerësimi për një njësi gjeneruese të parasë, anulimi nuk do të rritë vlerën kontabël neto të një aktivi mbi vlerën që është më e ulëta mes:</p> <p>(i) shumës së tij të rikuperueshme; dhe</p> <p>(ii) vlerës kontabël neto që do të kishte patur nëse nuk do të ishte njohur humbje nga zhvlerësimi për aktivin në periudhat e mëparshme.</p> <p>(d) Çdo tejkalim i shumës së anuluar të humbjes nga zhvlerësimi që nuk mund t'i shpërndahet një aktivi për shkak të kufizimit në pikën (c) më sipër, do të shpërndahet proporcionalisht në aktivet e tjera të njësisë gjeneruese të parasë, me përjashtim të emrit të mirë;</p> <p>(e) Pasi është njohur një anulim i një humbjeje nga zhvlerësimi, nëse është e zbatueshme, njësia ekonomike do të rregullojë shpenzimet e amortizimit për çdo aktiv në njësinë gjeneruese të parasë në periudhat e ardhshme për shpërndarjen e vlerës kontabël neto të rishikuar të aktivit, pakësuar me vlerën e tij të mbetur (nëse ka), në mënyrë sistematike mbi jetën e mbetur të dobishme të tij.</p>
	Rimarrja për një aktiv të veçantë të zhvlerësuar
105	<p>Kur humbja e mëparshme nga zhvlerësimi është bazuar në shumën e rikuperueshme të aktivit të veçantë të zhvlerësuar, do të zbatohen kërkesat në vijim:</p> <p>(a) Njësia ekonomike duhet të vlerësojë shumën e rikuperueshme të aktivit në datën e raportimit aktual;</p> <p>(b) Nëse shuma e rikuperueshme e vlerësuar e aktivit e tejkalon vlerën kontabël të tij, njësia ekonomike do të rritë vlerën kontabël neto deri në shumën e rikuperueshme, që i nënshtrohet kufizimit të përshkruar në pikën (c) më poshtë. Kjo rritje është anulimi i një humbjeje nga zhvlerësimi. Njësia duhet të njohë menjëherë anulimin në fitim ose humbje;</p> <p>(c) Anullimi i një humbjeje nga zhvlerësimi nuk do të rritë vlerën kontabël neto të aktivit mbi atë që do të kishte qenë (neto nga amortizimi) nëse nuk do të ishte njohur humbje nga zhvlerësimi për aktivin në vitet e mëparshme;</p> <p>(d) Pasi është njohur një anulim i një humbjeje nga zhvlerësimi, njësia ekonomike do të rregullojë shpenzimet e amortizimit për aktivin në periudhat e ardhshme për shpërndarjen e vlerës kontabël neto të rishikuar të aktivit, pakësuar me vlerën e tij të mbetur (nëse ka), në mënyrë sistematike mbi jetën e mbetur të dobishme të tij.</p>
	PARAQITJA NË PASQYRAT FINANCIARE
106	<p>AAM-të paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar në zërat përkatës të formatit të dhënë në SKK 2 i përmirësuar, <i>Paraqitja e pasqyrave financiare</i>. Lejohet gjithashtu një klasifikim i mëtejshëm i zërave të aktiveve (për shembull, “Toka”, “Ndërtesa”, “Makineri dhe pajisje”).</p>
107	<p>Shpenzimet e amortizimit të AAM-ve dhe AAJM-ve, si dhe humbjet nga zhvlerësimi, paraqiten si zë më vete i formatit 1 të pasqyrës së performancës, si dhe në zërat përkatës të formatit 2, në varësi të funksioneve të aktiveve në njësinë ekonomike. Fitimet/humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit të AAM dhe AAJM njihen në zërat “Shpenzime të tjera të shfrytëzimit”.</p>
	SHËNIMET SHPJEGUESE
108	<p>Në pasqyrat financiare shpjegohen bazat e matjes të përdorura për përcaktimin e vlerës kontabël bruto (e aplikueshme vetëm për AAM), metodat dhe normat e amortizimit (ose jeta e dobishme), të përdorura për amortizimin e të gjitha grupeve të AAM dhe AAJM, analiza e ndryshimit në vlerën kontabël të tyre, si dhe rakordimi i informacionit të mëposhtëm:</p> <p>(a) kosto, amortizimi i akumuluar dhe vlera kontabël në fillim të vitit ushtrimor;</p> <p>(b) blerjet dhe përmirësimet gjatë periudhës kontabël;</p> <p>(c) shtesat nga kombinimet e bizneseve;</p> <p>(d) shpenzimet e amortizimit;</p> <p>(e) zvogëlimet nga humbjet prej zhvlerësimit;</p> <p>(f) rimarrjet e humbjeve të mëparshme nga zhvlerësimi;</p> <p>(g) daljet jashtë përdorimit/shitjet;</p> <p>(h) riklasifikimet (duke përfshirë aktivet afatgjata të mbajtura për shitje);</p> <p>(i) ndryshime të tjera;</p> <p>(j) kosto, amortizimi i akumuluar dhe vlera kontabël në fund të periudhës kontabël.</p> <p>Ky rakordim nuk duhet të paraqitet për periudhën e mëparshme.</p>
109	<p>Gjithashtu, njësia ekonomike do të japë informacionet e mëposhtme:</p> <p>(a) Vlera kontabël e elementeve të AAM dhe AAJM, të mbajtura peng si garanci për huamarrjet, apo në të cilat njësia ekonomike ka një titull të kufizuar;</p> <p>(b) shuma e angazhimeve kontraktore për blerjen e tokës, ndërtesave, makinerive dhe pajisjeve.</p>
110	<p>Një njësi ekonomike duhet të japë për AAJM informacionin e mëposhtëm shpjegues:</p> <p>(a) një përshkrim të vlerës kontabël neto dhe periudhës së amortizimit të çdo aktivi jomaterial që konsiderohet</p>

	material për pasqyrat financiare të njësisë; (b) për aktivet jomateriale të përfuara nëpërmjet një granti të qeverisë dhe të njohur fillimisht me vlerën e drejtë: (i) vlerën e drejtë të njohur fillimisht për këto aktive; dhe (ii) vlerat kontabël neto të tyre.	
111	Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për shumën totale të shpenzimeve të kërkimit dhe zhvillimit të njohura si shpenzime periudhe.	
112	Një njësi ekonomike duhet të japë informacionin shpjegues të mëposhtëm për çdo klasë të aktiveve të përcaktuara në paragrafin 113: (a) shumën e humbjeve nga zhvlerësimi, e njohur në fitim ose humbje gjatë periudhës dhe nënzerin (nënzërat) në pasqyrën e performancës në të cilin (cilët) janë të përfshira këto humbje nga zhvlerësimi; (b) shumën e anulimeve të humbjeve nga zhvlerësimi të njohura në fitim ose humbje gjatë periudhës dhe nënzerin (nënzërat) në pasqyrën e performancës në të cilin (cilët) janë të përfshira këto humbje nga zhvlerësimi.	
113	Një njësi ekonomike do të japë informacionet shpjeguese të kërkuara nga paragrafi 112 për secilën nga klasat e mëposhtme të aktiveve: (a) aktivet afatgjata materiale; (b) emrin e mirë; (c) aktivet afatgjata jomateriale.	
114	Një njësi ekonomike duhet të japë informacionet shpjeguese në vijim për të gjitha aktivet afatgjata të investuara: (a) metodat dhe supozimet e rëndësishme të përdorura në përcaktimin e vlerës së drejtë të aktiveve afatgjata të investuara; (b) shkallën në të cilën vlera e drejtë e aktivitet afatgjatë të investuar (siç është matur apo dhënë informacioni shpjegues në pasqyrat financiare) është bazuar në një vlerësim të bërë nga një ekspert i pavarur që ka një kualifikim profesional të njohur dhe përkatës dhe përvojën e fundit në vendin dhe klasën e aktivitet afatgjatë të investuar që është duke u vlerësuar. Nëse nuk ka pasur vlerësim të tillë, duhet të jepet informacion shpjegues për këtë fakt; (c) ekzistencën dhe shumën e kufizimeve për mundësinë e realizimit të aktivitet afatgjatë të investuar apo remitancat e të ardhurave nga dalja jashtë përdorimit; (d) detyrimet kontraktuale për blerjen, ndërtimin dhe zhvillimin e aktivitet afatgjatë të investuar ose për riparime, mirëmbajtje apo zgjerime; (e) rakordimin ndërmjet vlerave kontabël të aktiveve afatgjatë të investuar në fillim dhe në fund të periudhës, duke i treguar veçmas: (i) shtesat, duke dhënë informacion shpjegues në mënyrë të veçantë për ato shtesa që rrjedhin nga blerjet nëpërmjet kombinimeve të biznesit; (ii) fitimet ose humbjet neto nga rregullimet e vlerës së drejtë; (iii) transferimet në toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje, kur nuk është më e disponueshme një masë e besueshme e vlerës së drejtë, pa kosto apo përpjekje të panevojshme; (iv) transferimet në dhe nga inventarët apo pasuri e zotëruar nga pronari; (v) ndryshime të tjera. Ky rakordim nuk duhet të paraqitet për periudhat e mëparshme.	
	DISPOZITA KALIMTARE	
115	Në vitin e parë të zbatimit të këtij standardi të përmirësuar, njësi ekonomike inkurajohet por nuk kërkohet të zbatojë në mënyrë retrospektivë këtë standard. Nëse nuk mund të bëhet zbatimi në retrospektivë pa kosto shtesë do të jepen informacione tek shënimet shpjeguese lidhur me trajtimin kontabël të shpenzimeve të zhvillimit dhe kostove të huamarrjes në të shkuarën duke shpjeguar edhe arsyet e moskrahueshmërisë së pasqyrës paraardhëse me atë të vitit aktual.	
	DATA E HYRJES NË ZBATIM	
116	Ky Standard do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël, që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2015.	
	KRAHASIMI ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR PËR NVM-të (2009)	
117	Tabela më poshtë tregon se si korrespondojnë përbajtjet e këtij Standardi me SNRF për NVM. Paragrafët janë trajtuar si korresponduese, nëse ato trajtojnë në përgjithësi të njëjtën çështje, pavarësisht nga fakti se seksionet e referuara mund të kenë ndryshim.	
	Paragrafët sipas SKK 5	
	Paragrafët sipas SNRF për NVM botuar në korrik 2009	
	Paragrafi 1	Asnjë
	Paragrafi 2	Asnjë
	Paragrafi 3	Asnjë
	Paragrafi 4	Sek 17.1, Sek 18.1

Paragrafi 5	Sek 17.3, Sek 18.3
Paragrafi 6	Sek 27.1
Paragrafi 7	Sek 17.2, Sek 18.2, Sek 25.1
Paragrafi 8	Sek 17.4
Paragrafi 9	Sek 17.5
Paragrafi 10	Sek 17.8
Paragrafi 11	Sek 17.9, 17.10
Paragrafi 12	Sek 17.12
Paragrafi 13	Sek 17.13
Paragrafi 14	Sek 25.2
Paragrafi 15	Sek 17.14
Paragrafi 16	Sek 17.16
Paragrafi 17	Asnjë
Paragrafi 18	Sek 17.15
Paragrafi 19	Asnjë
Paragrafi 20	Asnjë
Paragrafi 21	Asnjë
Paragrafi 22	Asnjë
Paragrafi 23	Asnjë
Paragrafi 24	Asnjë
Paragrafi 25	Asnjë
Paragrafi 26	Asnjë
Paragrafi 27	Asnjë
Paragrafi 28	Asnjë
Paragrafi 29	Sek 17.18
Paragrafi 30	Asnjë
Paragrafi 31	Sek 17.21
Paragrafi 32	Sek 17.22
Paragrafi 33	Asnjë
Paragrafi 34	Asnjë
Paragrafi 35	Sek 17.17
Paragrafi 36	Sek 17.23
Paragrafi 37	Sek 17.19
Paragrafi 38	Asnjë
Paragrafi 39	Asnjë
Paragrafi 40	Sek 17.10
Paragrafi 41	Asnjë
Paragrafi 42	Sek 17.25
Paragrafi 43	Asnjë
Paragrafi 44	Sek 17.6
Paragrafi 45	Sek 17.7
Paragrafi 46	Asnjë
Paragrafi 47	Sek 16.2
Paragrafi 48	Sek 16.3
Paragrafi 49	Sek 16.4
Paragrafi 50	Sek 16.5
Paragrafi 51	Sek 16.6
Paragrafi 52	Sek 16.7
Paragrafi 53	Sek 16.8
Paragrafi 54	Sek 16.9
Paragrafi 55	Sek 18.4
Paragrafi 56	Sek 18.8
Paragrafi 57	Sek 18.9
Paragrafi 58	Sek 18.10
Paragrafi 59	Sek 18.14
Paragrafi 60	Sek 18.15

	Paragrafi 61	Sek 18.16
	Paragrafi 62	Sek 18.17
	Paragrafi 63	Sek 18.11
	Paragrafi 64	Sek 18.12
	Paragrafi 65	Sek 18.13
	Paragrafi 66	Sek 18.18
	Paragrafi 67	Sek 18.21
	Paragrafi 68	Sek 18.22
	Paragrafi 69	Asnjë
	Paragrafi 70	Sek 18.19
	Paragrafi 71	Sek 18.20
	Paragrafi 72	Sek 18.23
	Paragrafi 73	Sek 17.27, Sek 18.26
	Paragrafi 74	Sek 17.28
	Paragrafi 75	Sek 17.29
	Paragrafi 76	Sek 17.30
	Paragrafi 77	Asnjë
	Paragrafi 78	Asnjë
	Paragrafi 79	Asnjë 6
	Paragrafi 80	Asnjë 7
	Paragrafi 81	Asnjë
	Paragrafi 82	Sek 27.1
	Paragrafi 83	Sek 27.5
	Paragrafi 84	Sek 27.6
	Paragrafi 85	Sek 27.7
	Paragrafi 86	Sek 27.9
	Paragrafi 87	Sek 27.8
	Paragrafi 88	Sek 27.10
	Paragrafi 89	Sek 27.11
	Paragrafi 90	Sek 27.12
	Paragrafi 91	Sek 27.13
	Paragrafi 92	Sek 27.14
	Paragrafi 93	Sek 27.15
	Paragrafi 94	Sek 27.16
	Paragrafi 95	Sek 27.17
	Paragrafi 96	Sek 27.18
	Paragrafi 97	Sek 27.19
	Paragrafi 98	Sek 27.20
	Paragrafi 99	Sek 27.21
	Paragrafi 100	Sek 27.22
	Paragrafi 101	Sek 27.23
	Paragrafi 102	Sek 27.24
	Paragrafi 103	Sek 27.29
	Paragrafi 104	Sek 27.31
	Paragrafi 105	Sek 27.30
	Paragrafi 106	Asnjë
	Paragrafi 107	Asnjë
	Paragrafi 108	Sek 17.31 & 18.27
	Paragrafi 109	Sek 17.32
	Paragrafi 110	Sek 18.28
	Paragrafi 111	Sek 18.29
	Paragrafi 112	Sek 27.32
	Paragrafi 113	Sek 27.33
	Paragrafi 114	Sek 16.10
	Paragrafi 115	Asnjë
	Paragrafi 116	Asnjë

